



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 314/5 Prot

Tiranë, më 17/3/2022

VENDIM

Nr. 04, datë 17.3.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 314 Prot., datë 08.02.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkuesit, ankuesi, nëpërmjet kërkesës datë 21.01.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Rotacionin e fundit të komisionerëve të teorisë dhe praktikës, lëvizjet përkatëse dhe emrat e tyre.
2. Emrat e të gjithë komisionerëve sipas drejtorive rajonale përkatëse.
3. Kopje të kontratave me subjekte private, që lidhen me sigurinë rrugore, për emisione të mundshme televizive, reklama, spote ndërgjegjësuese etj..., gjatë vitit 2021.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1592/1 Prot., datë 04.02.2022, ka kthyer përgjigje duke cituar se: “...Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”), si institucion shtetëror, është person juridik, publik, jo buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për transportet, e krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.343, datë 21.07.1999 “Për krijimin e DPSHTRR”, e cila ushtron veprimtarinë e saj mbi shërbimet për mjetet rrugore dhe mbi shërbimet për drejtuesit e mjeteve rrugore. Në strukturën e saj organizative por edhe atë të Drejtorive Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor, miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, DPSHTRR nuk ka pozicion pune me emërtimin, komisioner të teorisë dhe praktikës. Sa i përket kërkimit mbi kontratat e lidhura me objekt sigurinë rrugore, për arsye konfidencialiteti, bazuar në nenin 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, nuk mund të vendoset në dispozicion kopje të kontratës me palë private pa marrë pëlqimin”.

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar, pretendon se: “...pika 1 e nenit 12 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikon që “Në rastet kur autoriteti publik, të cilit i drejtohet kërkesa për informim, është i paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e kërkesës, ai kontakton menjëherë, por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës, me kërkuesin për të bërë sqarimet e nevojshme. Në çdo rast, autoriteti publik ndihmon kërkuesin në saktësimin e kërkesës”. Kjo pikë është shkelur nga DPSHTRR, pasi nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për qartësimin e dy pikave të para të kërkesës në lidhje me komisionerët apo inspektorët e testeve të teorisë dhe praktikës. DPSHTRR, është shumë e qartë se bëhet fjalë për komisionerët apo inspektorët, për personat që verifikojnë nëse kursantët janë aftësuar për të marrë lejen e drejtimit apo jo, pra ata që ndjekin testet praktike dhe testet teorike, i kontrollojnë dhe vlerësojnë aftësitë e kursantit që ka ndjekur kursin në një autoshkollë.

Gjithashtu, baza ligjore e referuar nga DPSHTRR (neni 17 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”) nuk parashikon në asnjë rrethanë konfidencialitetin e një marrëveshje mes një autoriteti publik dhe një subjekti privat. Shpenzimet dhe kontratat e një autoriteti publik nuk mund përbëjnë sekret, vetëm ku jemi në kushtet e parashikuara në nenin 17 të ligjit të sipërcituar”.

Në këto kushte, ankuesi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat

*e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri, me shkresën nr. 314/1 Prot., datë 14.02.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe rivlerësimin e dhënies së dokumentacionit të kërkuar në përputhje me dispozitat e cituara.*

*Autoriteti Publik, në vijim me shkresën nr. 1592/3 Prot., datë 21.02.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 314/2 Prot., datë 23.02.2022 ka sqaruar se: “...Në shprehje të predispozitës maksimale për të kooperuar me median e lirë, në ndërgjegjësimin e qytetarit për të drejtat e tij, e njohim me strukturat e varësisë së DPSHTRR-së, që bëjnë provën e kontrollit të njohurive teorike dhe provën e verifikimit të aftësive drejtuese dhe të sjelljes për kandidalet për drejtues mjeti, si dhe lëvizjet paralele të kryera për seciun rreth.*

*Emrat e tyre në kuptim të akteve ligjore në fuqi nuk janë informacion publik që mund të vihet në dispozicion sipas LDI, pasi nuk është një e dhënë e përpiluar nga asnjë autoritet publik. Përdorimi i tyre i nënshtrohet VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e regjistrit qendror të personelit”, në kreun I, pika 5 ku parashikohet:*

*Dosja e personelit ka karakter konfidencial. Personat që kanë të drejtë të njihen me këtë dosje janë:*

- a) eprori direkt;*
- b) nëpunësit e njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore që përgjigjen për mbajtjen dhe sistemimin e tyre;*
- c) nëpunësi/punonjësi, të cilit i përket dosja;*
- ç) Komisioneri i Shërbimit Civil;*
- d) Departamenti i Administratës Publike;*
- dh) Sekretari i Përgjithshëm,*
- e) titullari i institucionit;*
- ë) si dhe institucione të tjera të ngarkuara nga ligji.*

*Në kuptim të pikës ë), nuk jemi përpara një kërkesë institucionale.*

*Në vijim të informacionit për pyetjen e parë, siç është sqaruar në shkresën nr. 1592/1 prot., datë 04.02.2022, DPSHTRR-ja në strukturën e saj nuk ka pozicione pune me emërtimin komisionerë të teorisë dhe praktikës dhe as pozicion me emërtimin, inspektorë të teorisë dhe praktikës. Lëvizjet paralele të këtyre punonjësve kryhen në zbatim të aftësive të tyre profesionale, nevojave administrative të drejtorive si dhe respektimit të plotë të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar. DPSHTRR në rolin e punëdhënësit në zbatim të legjislacionit që rregullon mardhëniet e punës, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar, si dhe kontratës së punës të lidhur me punëmarrësin ka detyrimin ligjor të mbrojtjes së të dhënave personale të punonjësit, konfidencialitetit të dosjes së personelit si dhe mbrojtjen e personalitetit të tij.*

*Në bazë të VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrit qendror të personelit”, janë të përcaktuara organet përkatëse të cilat mund të njihen me të dhënat e punëmarrësve, ku raste të ardhura me kërkesë si ajo e ankuesit, nuk legjitimohen.*

*Gjithashtu sipas nenit 3, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, e dhënë personale është informacioni që mundëson identifikimin e një personi të caktuar qoftë direkt, qoftë indirekt, duke quajtur privatësi ndër të tjera edhe emër, mbiemër. Të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin, përfundimisht nuk mund të konsiderohet emri dhe mbiemri si një e dhënë publike për mediat sipas parashikimeve të nenit 3, pika 1, dhe e cila duhet të jepet sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 4, të LDI. Nisur nga sa më sipër dhe duke qënë se pozicioni i punës së këtyre punonjësve nuk bën pjesë tek ato pozicione që lidhen me funksione të larta të shtetit apo persona që përbëjnë figura publike që kanë detyrime ligjore për publikimin e të dhënave të tyre, ata gëzojnë një nivel më të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale. Ndërsa, për sa lidhet me pyetjen mbi kontratat me subjektet private dhe vënien në dispozicion të tyre, bazuar në nenin 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të dhënat personale përpunohen vetëm nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin. Kontrata si një veprim juridik midis dy palëve, përmban detyrime të dyanshme, ku palët detyrohen reciprocikisht ndaj njëra-tjetrës. DPSHTRR-ja nuk mund të vërë në dispozicion këto kontrata pa marrë pëlqimin e tyre. Citojmë që pala kontraktore nuk shprehu pëlqimin për vendosjen e kopjes së kontratës në dispozicion të ankuesit. Mbi këtë kërkesë, DPSHTRR sqaron që gjatë vitit 2021 nuk ka lidhur asnjë kontratë me subjekte private me objekt zhvillimin e emisioneve televizive, reklama, apo spote ndërgjegjësuese mbi sigurinë rrugore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar apo ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”. DPSHTRR pjesërisht për vitin 2021 (në dhjetor) dhe vijimin e vitit 2022, në bazë të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, ka lidhur kontratë sponsorizimi me fondacionin mediatik “Dritan Hoxha”, për mbështetje financiare mbi realizimin e programit edukativ televiziv “N’timon”, në kuadër të tematikës “Siguria Rrugore”, me qëllim sensibilizimin e drejtuesve të rinj të mjetit për mostejkalim shpejtësie, domosdoshmërinë e përdorimit të rrypit të sigurimit, mospërdorimi i alkolit në timon, përdorimi i aparateve telefonike si dhe shkeljeve të tjera të rregullave të qarkullimit rrugor nga çdo përdorues rruge...”.*

Në vijim, ankuesi pretendon se qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik me anë të kësaj shkrese, është në kundërshtim me LDI, në këto kushte ka vijuar me ankimin e regjistruar me nr. 314/3 Prot., datë 25.02.2022.

Pas vijimit të ankimit, Autoriteti Publik me shkresën nr. 1592/4 Prot., datë 07.03.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 314/4 Prot., datë 08.03.2022 ka rikonfirmuar qëndrimin, duke sqaruar se: “...në zbatim të nenit 17, të LDI, ku citohet që e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e të drejtës për një jetë private dhe të drejtën për aktivitet të lirë tregëtar, e konsideron të ezauruar me përmbajtjen e shkresës nr.1592/3 prot., datë 21.02.2022, përgjigjen e kërkesës protokolluar me tonën nr. 1592 prot, datë 24.01.2022, për aq kohë sa nga ana e ankuesit nuk vërtetohet se infomacioni i kërkuar do të përdoret në favor të një interesi publik më të lartë se mbrojtja e të dhënave personale të punonjësve të institucionit. Lidhur me pretendimin e ankuesit “...mbi

*moszbatimin e rotacionit të komisionerëve”, legjislacioni i marrdhënieve të punës nuk e njih termin rotacion të punëmarrësve. Ndërkohë, sa i përket lëvizjeve paralele të cilat kryhen në zbatim të aftësive profesionale, nevojave administrative të drejtorive si dhe respektimit të plotë të ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, nga DPSHTRR i është vendosur në dispozicion informacioni sipas tabelës numër 2, bashkëlidhur shkresës nr. 1592/3 prot., datë 21.02.2022.”*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, nisur nga informacioni që kërkohet, kjo çështje duhet të trajtohet me LDI, por edhe me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”).

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të sipërcituara, rezulton se Autoriteti Publik, lidhur me pikën 1 dhe 2 të kërkesës për informacion ka vendosur në dispozicion një informacion lidhur me lëvizjet paralele të punonjësve si dhe strukturën organizative të drejtorive, por jo emrat e tyre apo lëvizjet përkatëse. Në këto kushte, vlerësohet se, kërkesa lidhur me këto dy pika është përmbushur pjesërisht nga Autoriteti Publik.

Në nenin 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.* Në kuptim të këtij parashikimi, DPSHTRR është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Në qëndrimin e Autoritetit Publik konstatohet se, kufizimi i aksesit është bërë në referim të nenit 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe VKM-së nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit”, pa marrë parasysh dispozitat përjashtuese të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në parim, e drejta e aksesit në të dhënat personale sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është një e drejtë që gëzohet nga subjekti i të dhënave personale.

Në rastin konkret, kërkesa për informacion e paraqitur nga ankuesi bazohet në LDI dhe në nenin 17 të tij jepen rastet e kufizimit të dhënies së informacionit, ku një nga kufizimet është edhe ruajtja e jetës private. Në rastin konkret, duke qenë se kërkohen të dhëna që lidhen me ushtrimin e detyrës funksionale (emër, mbiemër) të punonjësve në një autoritet publik sipas VKM-së nr. 343, datë 21.07.1999 “Për krijimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor”, gjen zbatim shkronja b) e pikës 4 të nenit 4 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin parashikohet se *“Ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik*

*zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre”.*

Ky parashikim aplikohet sipas legjislacionit në mënyrë proporcionale dhe në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë të të dhënave. Në këtë kuptim, përhapja e informacionit duhet të kufizohet vetëm me aksesimin e dokumenteve të dosjes personale të subjektit të të dhënave (*kopje e diplomës, etj*), që përmbajnë të dhëna personale të lidhura ngushtësisht me individin dhe, si të tilla, nuk mund të vihen në dispozicion të askujt pa pëlqimin paraprak të tij. Ndërkohë, nga verifikimi i kërkesës rezulton se ajo konsiston në marrjen e informacionit mbi emrat e të gjithë punonjësve sipas drejtorive rajonale përkatëse pranë DPSHTRR dhe jo aksesimin e dokumentacionit që përmban të dhëna personale, për të cilat mund të zbatohen dispozitat e cituara në VKM-në nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit dhe regjistrin qendror të personelit” nga Autoriteti Publik.

Ndërkohë, në pikën 3 të kërkesës kemi të bëjmë me kontrata të lidhura midis Autoritetit Publik dhe subjekteve private. Për këtë pikë, Autoriteti Publik ka deklaruar se gjatë vitit 2021 nuk ka lidhur asnjë kontratë me subjekte private me objekt zhvillimin e emisioneve televizive, reklama, apo spote ndërgjegjësuese mbi sigurinë rrugore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar apo ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik. Ndërkohë, disponohet një kontratë sponsorizimi, pjesërisht për vitin 2021 (në dhjetor) dhe vijimin e vitit 2022, në bazë të ligjit nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar, për të cilën ky i fundit, pretendon se nuk mund ta vendosë në dispozicion për shkak se pala kontraktore nuk ka shprehur pëlqimin për dhënien e saj.

Gjatë hetimit administrativ, Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese, të përcaktuar në këtë kontratë, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në kërkesën për informacion datë 21.01.2022 përmbush kriteret e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Ndërkohë, për pikën 3 të kërkesës për informacion, Autoriteti Publik duhet të rivlerësojë dokumentacionin dhe vetëm nëse kontrata përmban të dhëna personale të subjekteve të të dhënave të cilët nuk janë përfaqësues të shoqërisë tregtare,

përhapja e të dhënave mund të çënojë privatësinë e tyre, në këtë rast këto të dhëna duhet të anonimizohen, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit të sipërcituar.

Në lidhje me pretendimin e moslegjitimit të kërkuarit, Komisioneri thekson se LDI nuk kushtëzon dhënien e informacionit/dokumentacionit të konsideruar publik me paraqitjen nga ana e kërkuarit të arsyeve apo interesit që ka në marrjen e këtij informacioni. Për më tepër, kërkuari/ankuesi është një gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik.

Bazuar në pikën 1 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet”*.

Ndërkohë, bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës nr. 314 Prot., datë 08.02.2022, nga z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 21.01.2022, konkretisht: (1. Rotacionin e fundit të komisionerëve të teorisë dhe praktikës, lëvizjet përkatëse dhe emrat e tyre. 2. Emrat e të gjithë komisionerëve sipas drejtorive rajonale përkatëse. 3. Kopje të kontratave me subjekte private, që lidhen me sigurinë rrugore, për emisione të mundshme televizive, reklama, spote ndërgjegjësuese etj..., gjatë vitit 2021), brenda

datës 25 . 3 .2022, duke respektuar kufizimet për pikën e tretë të saj, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17 . 3 .2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

